

**RAPORTI I NDËRMJETËM NR. 1\***  
**8–21 maj 2009**

**26 maj 2009**

**I. PËRMBLEDHJE**

- Më 14 Janar Presidenti i Republikës së Shqipërisë shpalli 28 qershorin si datën e zgjedhjeve parlamentare. Zgjedhjet do të zhvillohen me një sistem të ri rajonal proporcional sipas të cilit 140 deputetet e Kuvendit (Parlamentit) do të zgjidhen në 12 zona.
- Një Kod Zgjedhor i rishikuar dhe i përmirësuar ndjeshëm u miratua në dhjetor 2008 si rezultat i reformave më të fundit zgjedhore.
- Tridhjetë e gjashtë parti politike kanë dorëzuar listat e kandidatëve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Përveç kësaj, dy kandidatë të pavarur paraqitën firma të mbështetësve. Tridhjetë e tre parti do të garojnë në zgjedhje si pjesë e njërit nga katër koalicionet.
- Skena politike mbetet tepër e polarizuar mes Partisë Demokratike (PD) dhe Partisë Socialiste (PS). Megjithëse fushata zyrtare fillon më 29 maj, disa parti kanë filluar fushatën aktive, çka nuk ndalohet nga Kodi Zgjedhor.
- Zgjedhjet do të administrohen nga një administratë zgjedhore me tri shkallë, e cila përfshin KQZ-në, 66 Komisione të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) dhe rreth 4.800 Komisione të Qendrave të Votimit (KQV). Votat do të numërohen në 66 Qendra të Numërimit të Votave (QNV). KQZ-ja, me përbërjen e tanishme shumëpartiake, u caktua në shkurt 2009.
- Çështja e Kartave të Identitetit është çështja më e debatueshme e procesit zgjedhor deri tani. Sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme, deri tani kanë aplikuar për Karta Identiteti rreth 354.000 zgjedhës nga 730.000 që llogaritet të jetë numri i përgjithshëm i zgjedhësve pa pasaportë të vlefshme. Megjithëse qeveria ka besim se do të arrijë të pajisë me karta të gjithë zgjedhësit pa pasaportë, personat me të cilët ka biseduar Misioni Vëzhgues i OSBE/ODIHR-it, sidomos ata nga rradhët e opozitës, kanë vënë në dyshim faktin nëse kjo do të mund të arrihet brenda kohës së kufizuar që ka mbetur. Disa parti kanë ngritur dyshime se aplikimet po trajtohen në mënyrë selektive duke krijuar disavantazh për mbështetësit e tyre.
- Shqipëria ka një numër të madh mediash që shihen si pluraliste, por jo të pavarura nga ndikimet politike. Kodi Zgjedhor përmban rregulla të hollësishme për paraqitjen mediatike të fushatës, për shpërndarjen e kohës së transmetimeve falas në radion dhe televizionin publik dhe për reklamat me pagesë.
- Deri tani, në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit në Tiranë janë bërë dy ankesa ndaj vendimeve dhe udhëzimeve të KQZ-së. Të dyja u hodhën poshtë mbi baza teknike
- Misioni Vëzhgues i OSBE/ODIHR-it filloi punën në Tiranë më 8 maj me 14 anëtarë të ekipit kryesor dhe 26 vëzhgues afatgjatë të vendosur në 12 zona në të gjithë vendin, të cilët vijnë nga 20 vendet pjesëmarrëse të OSBE-së.

\* I vetmi version zyrtar i këtij dokumenti është ai në gjuhën angleze.

## II. HYRJE

Më 14 janar 2009, Presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Bamir Topi, caktoi mbajtjen e zgjedhjeve të përgjithshme më 28 qershor. Pas një Misioni për Vlerësimin e Nevojave dhe në përgjigje të një ftese të mëparshme nga Ministria e Punëve të Jashtme, Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR) dërgoi në Shqipëri Misionin për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ) më 8 maj. MVZ-ja e kryesuar nga Ambasadorja Audrey Glover (Odri Glavë) përbëhet nga një ekip qendror prej 14 vetësh me bazë në Tiranë dhe 26 vëzhgues afatgjatë të vendosur në 12 zona të ndryshme të vendit. Misioni Vëzhgues i OSBE/ODIHR-it është përzgjedhur nga 20 vende pjesëmarrëse në OSBE. Shteteve pjesëmarrëse iu kërkua të dërgojnë 400 vëzhgues afatshkurtër për të vëzhguar votimin, numërimin dhe nxjerrjen e rezultateve të votimit.

## III. SITUATA

Zgjedhjet parlamentare do të mbahen në vijim të amendamenteve kushtetuese dhe miratimit të Kodit Zgjedhor të rishikuar në vitin 2008. Këto zgjedhje do të jenë të parat që zhvillohen me sistemin rajonal proporcional, i cili zëvendësoi sistemin e mëparshëm kontroversial zgjedhor. Reformat u miratuan në një atmosferë mirëkuptimi mes dy partive më të mëdha, Partisë Demokratike (PD) dhe Partisë Socialiste (PS). Shumë parti të vogla shprehën pakënaqësi ndaj sistemit të ri zgjedhor, i cili, sipas tyre, favorizonte dy partitë e mëdha, duke vënë në disavantazh partitë e vogla. Zgjedhjet e fundit parlamentare të korrikut 2005 u fituan nga një koalicion i drejtuar nga PD-ja. Zgjedhjet më të fundit ishin zgjedhjet vendore në shkurt 2007. OSBE/ODIHR-i vlerësoi se të dyja këto zgjedhje i kishin përmbushur vetëm pjesërisht angazhimet e OSBE-së, megjithëse shënuan njëfarë progresi dhe krijuan kushtet për një garë konkurruese<sup>1</sup>.

## IV. KUADRI LIGJOR DHE SISTEMI ZGJEDHOR

Kuadri ligjor ku mbështeten këto zgjedhje përfshin Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, (1998, e ndryshuar për herë të fundit më 21 prill 2008) dhe Kodin Zgjedhor të miratuar nga Kuvendi (Parlamenti) më 29 dhjetor 2008. Gjithashtu, përdoren edhe nene të veçanta nga ligje të tjera, përfshirë Kodin Penal, Ligjin mbi Partitë Politike dhe Ligjin mbi Policinë e Shtetit. Dispozitat ligjore të caktuara nga Kodi Zgjedhor mbështeten dhe zbatohen me Vendimet dhe Udhëzimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. (KQZ)

Sipas Kushtetutës, Parlamenti përbëhet nga një dhomë e vetme me 140 deputetë që do të zgjidhen me anë të një sistemi përfaqësimi proporcional rajonal, me lista të mbyllura shumëëmërore brenda 12 zonave, që u korrespondojnë zonave administrative të vendit. Dymbëdhjetë zonat kanë madhësi të ndryshme dhe numri i mandateve varion nga katër për zonën e Kukësit në 32 për zonën e Tiranës. Kodi paracakton një prag ligjor prej tre përqind për partitë politike dhe pesë përqind për koalicionet që duhet arritur brenda një zone në mënyrë që partia apo koalicioni të marrë pjesë në shpërndarjen e mandateve.

## V. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

Partive politike që duan të marrin pjesë në zgjedhjet parlamentare u është kërkuar të regjistrohen si subjekte zgjedhore në KQZ. Dy ose më shumë parti të regjistruara si subjekte zgjedhore mund

---

<sup>1</sup> Të gjitha raportet e OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet në Shqipëri mund të gjenden në adresën <http://ëëë.osce.org/odihr-elections/14208.html>

të regjistrojnë një koalicion zgjedhor në KQZ. Partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore duhet të dorëzojnë në KQZ jo më vonë se 40 ditë para ditës së zgjedhjeve një listë shumëemërore për secilën zonë zgjedhore. Listat e kandidatëve të partive joparlamentare që kandidojnë në mënyrë individuale ose koalicionet që kanë më pak vende në Parlamentin të cilit po i mbaron mandati sesa numri i partive pjesëmarrëse në koalicion, duhet të paraqesin firmat e përkatësisht 10.000 dhe 15.000 zgjedhësve të regjistruar që i mbështesin në rang vendi. Kodi gjithashtu lejon individët që të paraqesin kandidaturën me propozim të një grupi zgjedhësish dhe me firmat e të paktën një përqind të zgjedhësve të regjistruar në zonën përkatëse. Zgjedhësit i depozitojnë firmat në mbështetje të partive ose kandidatëve në KQZ-së ose tek një noter. Një zgjedhës mund të mbështesë vetëm një kandidat, parti ose koalicion.

Për këto zgjedhje, në KQZ u regjistruan si subjekte zgjedhore 45 parti. Tridhjetë e katër prej tyre formuan katër koalicione të ndryshme. Sipas KQZ-së, 36 parti gjithësej kanë paraqitur listat e kandidatëve në KQZ. Nga këto, 33 parti janë pjesë e koalicioneve<sup>2</sup>, ndërsa tri parti të tjera do të dalin në zgjedhje vetëm. Përveç partive politike, tri komitete nismëtare të mbështetura nga grupe zgjedhësish u regjistruan në KQZ si subjekte zgjedhore. Dy prej tyre paraqitën dokumentet e nevojshme dhe firmat mbështetëse.

KQZ-ja filloi shqyrtimin e dokumenteve të kandidatëve më 21 maj dhe ka kohë deri më 24 maj që të përfundojë procesin e shqyrtimit. Në rastet kur partive u kërkohet të korrigjojnë gabimet në lista, dita e fundit që KQZ-ja të marrë vendim për to është 29 maji. PS-ja ishte partia e vetme që i dorëzoi listat pas skadimit të afatit, i cili ishte në mesnatën e 19 majit<sup>3</sup>. Partia Socialiste doli me pretendimin se kjo ndodhi për shkak se në KQZ nuk kishte njeri që t'i pranonte listat, çka u kundërshtua nga KQZ-ja.

## VI. SITUATA POLITIKE

Skena politike mbetet thellësisht e poliarizuar mes PD-së dhe PS-së. Megjithëse partitë e vogla e kundërshtuan sistemin e ri zgjedhor, shumë prej tyre arritën në përfundimin se do të kishin më shumë avantazhe si pjesë e një koalicioni dhe shumica e tyre u bashkuan me një nga katër koalicionet e këtyre zgjedhjeve.

Aleanca për Ndryshim u regjistrua si koalicion i përbërë nga 17 parti, duke përfshirë edhe Partinë Demokratike që udhëheq kryeministri Sali Berisha. Gjashtëmbëdhjetë parti të këtij koalicioni dorëzuan listat e kandidatëve në KQZ. Parti të tjera të koalicionit që kanë përfaqësues në parlamentin të cilit po i mbaron mandate, përfshijnë Partinë Republikane dhe Bashkimin Liberal Demokrat. Koalicioni Bashkimi për Ndryshim përbëhet nga pesë parti, përfshirë PS-në si edhe Partinë Socialdemokrate dhe Partinë Demokracia Sociale, të cilat kanë përfaqësues në parlamentin që po i mbaron mandati. Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut (PBDNJ) ishte pjesë e qeverisë aktuale të drejtuar nga PD-ja, por u bashkua me koalicionin e drejtuar nga PS-ja pak përpara mbarimit të afatit për regjistrimin e koalicioneve. Koalicioni Bashkimi për Ndryshim përfshin edhe një parti të re, Partinë G99, e cila u krijua nga figura të njohura të shoqërisë civile.

Aleanca Socialiste për Integrim është një koalicion prej gjashtë partish i udhëhequr nga Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) që rivalizon PS-në për votën e së majtëve. Ky koalicion përfshin edhe Partinë Socialiste të Vërtetë '91, e krijuar në fillim të vitit 2009 nga një fraksion brenda PS-së. Poli i Lirisë, një koalicion i qendrës së djathtë i përbërë nga gjashtë parti, u formua në prill

<sup>2</sup> Një parti në koalicionin e udhëhequr nga PD-ja nuk dorëzoi listat e kandidatëve.

<sup>3</sup> Në orën 8:00 më 20 maj, sipas librit të protokollit të KQZ-së.

2009. Ai përfshin Lëvizjen për Zhvillim Kombëtar dhe Partinë Demokristiane, e cila ishte pjesë e bllokut të udhëhequr nga PS-ja në zgjedhjet e 2005-ës.

Megjithëse fushata zyrtare 30-ditore fillon në datën 29 maj, disa parti kanë filluar fushatën aktive dhe udhëheqësit politikë kanë nisur turet elektorale në vend. Pavarësisht nga formimi i koalicioneve, aktivitetet e fushatës deri tani janë zhvilluar nga partitë në mënyrë të shkëputur, jo nga koalicionet e bashkuara. Shumë anëtarë të vegjël të koalicioneve theksojnë dëshirën për të shprehur identitetet e tyre të veçanta.

PD-ja e vë theksin tek arritjet e saj në qeveri, duke përfshirë anëtarësimin në NATO dhe aplikimin për anëtarësim në Bashkimin Europian, si dhe zhvillimin e infrastrukturës dhe luftën kundër korrupsionit. Partitë opozitare premtojnë përmirësime në fusha si infrastruktura, arsimi dhe shëndetësia. PD-ja dhe PS-ja akuzojnë njëra-tjetrën për korrupsion. Partitë e opozitës aludojnë se PD-ja ka përfitur nga fushatat televizive për informim publik në të cilat theksohen arritjet e qeverisë dhe që janë transmetuar para fushatës zgjedhore, kur partive nuk u lejohet të bëjnë reklama politike në televizion.

Një numër i madh partish politike kanë një mungesë të theksuar besimi ndaj administratës zgjedhore. Shumë parti të vogla shprehin pakënaqësi ndaj Kodit Zgjedhor që i jep PD-së dhe PS-së rol dominant në administratën zgjedhore në disavantazh për partitë e tjera. Parti të shumta kanë shprehur frikën se ditën e zgjedhjeve do të ketë parregullsi, sidomos gjatë procesit të numërimit.

## VII. ADMINISTRATA ZGJEDHORE

Zgjedhjet e ardhshme do të administrohen nga një administratë zgjedhore me tri shkallë, e cila përfshin KQZ-në, 66 Komisione të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) dhe rreth 4.800 Komisione të Qendrave të Votimit (KQV). Votat do të numërohen në 66 Qendra të Numërimit të Votave (QNV), një për secilën Zonë të Administrimit Zgjedhor.

KQZ-ja është një organ me shtatë anëtarë të zgjedhur nga Parlamenti. Tre anëtarë dhe kryetari caktohen nga shumica e parlamentit dhe tre anëtarë nga opozita.<sup>4</sup>

Për të administruar zgjedhjet parlamentare, 12 zonat ndahen në 66 Zona të Administrimit Zgjedhor. KQZ-ja i ka caktuar anëtarët e KZAZ-ve brenda afatit ligjor. KZAZ-të përbëhen nga shtatë anëtarë, përfshirë kryetarin dhe zëvendëskryetarin dhe ndihmohen nga një sekretar. Formula e emërimit të gjashtë anëtarëve është e njëjtë si ajo e KQZ-së. Në gjysmën e KZAZ-ve kryetari emërohet nga partia më e madhe e mazhorancës, ndërsa në gjysmën tjetër nga partia më e madhe e opozitës. Zëvendëskryetari dhe sekretari i përkasin kampit politik të kundërt me atë të kryetarit.

Votimi do të bëhet në Qendra Votimi (QV) dhe do të administrohet nga KQV-të që caktohen nga KZAZ-të sipas të njëjtës formulë që përdoret për KZAZ-të. Komisioni i Zonave të Administrimit Zgjedhor duhet t'i caktojë KQV-të deri në datën 19 maj, sipas emërimeve nga partitë politike. Në spitale, qendra paraburgimi dhe burgje do të ngrihen Qendra të posaçme Votimi. Kryetarët e bashkive dhe komunave duhet të kenë përcaktuar kufijtë dhe vendet e Qendrave të Votimit para datës 2 mars, duke mbajtur të njëjtat vende si në zgjedhjet e mëparshme, në rast se kjo është e mundur. Më 14 maj, KQZ-ja gjobiti 59 kryetarë bashkish dhe komunash për mosrespektim afati.

<sup>4</sup> Shih Raportin e OSBE/ODIHR-it për Vlerësimin e Nevojave, faqet 7 dhe 8, i cili mund të gjendet në adresën [http://ëëë.osce.org/documents/odihr-el/2009/04/37057\\_en.pdf](http://ëëë.osce.org/documents/odihr-el/2009/04/37057_en.pdf)

Në momentin e përgatitjes së raportit, KQZ-së i mungonin ende të dhënat nga gjashtë njësi të qeverisjes lokale.

Më 21 maj, KQZ-ja përfundoi ngritjen dhe caktimin e vendeve të të gjitha Qendrave të Numërimit të Votave (QNV). Brenda 23 qershorit KZAZ-të duhet të njoftojnë Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV) dhe vëzhguesit e subjekteve zgjedhore për vendet e QNV-ve në ZAZ-të përkatëse. Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor duhet të caktojnë Grupet e Numërimit jo më vonë se dy ditë para ditës së zgjedhjeve. Në përputhje me një dispozitë të re të Kodit Zgjedhor, në QNV do të vendosen kamera për t'u dhënë mundësinë të pranishëmve që të ndjekin votimin. Xhirimet do të ruhen dhe do t'i dorëzohen KQZ-së. Ato mund të përdoren si prova në ankimet paszgjedhore në rrugë administrative dhe gjyqësore. KQZ-ja po planifikon t'i transmetojë filmimet nga të gjitha QNV-të në ndërtesën e KQZ-së.

### VIII. IDENTIFIKIMI DHE REGJISTRIMI I ZGJEDHËSVE

Për herë të parë, listat e zgjedhësve (LZ) do të përpilohen nga baza e të dhënave elektronike të Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC), i cili mirëmbahet nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC) pranë Ministrisë së Brendshme (MB). Baza e të dhënave të RKGJC-së është zbardhja dixhitale a dosjeve të mbajtura nga Zyrat Vendore të Gjendjes Civile (ZVGJC), të cilat janë pjesë e qeverisjes vendore. Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të marrin një kopje të LZ-së falas nga kryebashkiaku ose kryekomunari i njësisë vendore përkatëse, apo nga vetë DPGJC-ja. Po ashtu, ata kanë të drejtë të marrin një kopje elektronike të LZ-së të të gjithë vendit. Numri i përgjithshëm i zgjedhësve të regjistruar është rreth 3.1 milion. Sipas DPGJC-së, rreth 50.000 duplikime janë hequr nga RKGJC-ja.

Lista e zgjedhësve përmban emrat e të gjithë zgjedhësve që jetojnë brenda kufijve të një zone të caktuar. Emrat e zgjedhësve vendosen në listën e zgjedhësve në vendin e tij/saj të regjistrimit, ku ai/ajo duhet të votojë. Vetëm personeli i Forcave të Armatosura, Policisë së Shtetit, të burgosurit, të paraburgosurit, pacientët që ndodhen në institucione shëndetësore dhe zyrtarët e zgjedhjeve mund të vihen në listën e zgjedhësve të një zone tjetër, e jo në zonën ku banojnë. Të gjithë zgjedhësit mund t'i kontrollojnë të dhënat e tyre në faqen e internetit të Ministrisë së Brendshme, apo në atë të KQZ-së.

Përpilimi i listave të zgjedhësve filloi më 29 janar, kur Zyrat e Gjendjes Civile hartuan Listat Paraprake të Zgjedhësve (LPZ) për territorin e njësisë së qeverisjes vendore. Më pas, kryetarët e bashkive dhe komunave ishin përgjegjës për ndarjen e mëtejshme të LPZ-së dhe caktimin e zonave që mbuloreshin nga secila qendër votimi. Listat Paraprake të Zgjedhësve u vunë në dispozicion të zgjedhësve për t'u kontrolluar prej tyre më 5 mars. Të gjitha kërkesat individuale për korrigjime duhet të jenë përfunduar deri më 4 maj. Periudha për ndryshimin e LZ-së, përfshirë ankime të mundshme në gjykatë, përfundon më 28 maj, kur do të nxirren nga RKGJC-ja listat përfundimtare të zgjedhësve dhe do t'u nisen KZAZ-ve përkatëse. Njëra kopje duhet të shpallet në qendrën e votimit. Nëse një zgjedhës regjistrohet në territorin e një zone përpara mbylljes së listës përfundimtare të zgjedhësve, por emri i tij/saj nuk është vënë në listë, ai/ajo ka të drejtë të paraqesë një kërkesë në gjykatën e rrethit gjyqësor, në mënyrë që t'i shtohet emri në listën e zgjedhësve. Kërkesa të tilla mund të shqyrtohen dhe për to të merret vendim deri në orën 13:00 ditën e zgjedhjeve.

Në mënyrë që të votojë, zgjedhësi duhet të paraqesë pasaportën e paskaduar, apo një kartë të vlefshme identiteti. Duke qenë se që nga vitet 1990 në Shqipëri nuk ishin nxjerrë dokumente të përshtatshme identifikimi për përdorim brenda vendit, në të kaluarën shumë zgjedhës përdornin të ashtëquajturat çertifikata lindjeje, të cilat kanë patur fotografi dhe lëshoheshin nga Zyrat

vendore të Gjendjes Civile. Gjatë zgjedhjeve të mëparshme, mungesa e dokumenteve të besueshme të identifikimit ka qenë burim shqetësimi dhe polemikash.

Më 12 janar, qeveria lançoi zyrtarisht një program, i cili kishte për qëllim pajisjen e të gjithë zgjedhësve me karta të reja identiteti me të dhëna biometrike. Edhe pse partitë opozitare e mbështetën këtë hap si një hap të nevojshëm për zhvillimin e një procesi të drejtë zgjedhjesh, këto parti e kritikuan ashpër qeverinë për vonimin e procesit deri në atë pikë sa, sipas mendimit të tyre, të rrezikonte zgjedhjet. Partia Socialiste ka paralajmëruar në mënyrë të vazhdueshme se koha për shpërndarjen me sukses të kartave të identitetit po mbaron dhe që, si rrjedhojë, një numër i konsiderueshëm zgjedhësish rrezikojnë të mos e ushtrojnë të drejtën e votës. Sipas Ministrisë së Brendshme, katër zyrat e fundit të regjistrimit do të hapen më 20 maj. Prodhimi i kartave të identitetit filloi në muajin shkurt.

Çështja e kartave të reja të identitetit është çështja më e kontestueshme deri tani në këtë proces zgjedhor. Sipas informacionit të marrë nga Ministria e Brendshme, deri në datën 19 maj, nga 730.000 zgjedhës që kanë të drejtën e votës por që nuk kanë pasaportë, rreth 354.000 kanë aplikuar për karta identiteti. Mendohet se rreth 160.000 zgjedhës shqiptarë, që kanë të drejtë të votojnë, jetojnë pa dokumente të vlefshme jashtë territorit të vendit. Rreth 200.000 zgjedhës duket të mos kenë aplikuar për karta identiteti deri tani. Ministria e Brendshme ka besim se do të jetë në gjendje ta pajisë këtë numër zgjedhësish me karta në kohë për zgjedhjet, ndërkohë që të tjerë nuk janë të bindur që firma e kontraktuar për menaxhimin e qendrave të aplikimit dhe prodhimin e kartave të identitetit, ka kapacitet për t'i bërë ballë një numri mundësisht të lartë aplikuesish në një periudhë të vonë në këtë proces.

Partitë opozitare janë ankuar se procesi i marrjes së kartave të reja të identitetit është vështirësuar në mënyrë artificiale. Madje disa, Partia Socialiste në veçanti, kanë thënë se aplikimet po kryhen në mënyrë të përzgjedhur në disa zona, në disavantazh të mbështetësve të tyre.

Çmimi fillestar prej 1.200 lekësh (rreth 9 euro) shkaktoi polemika mes qeverisë dhe opozitës, me këtë të fundit që kërkonte që kartat e identitetit të jepeshin falas përpara datës së zgjedhjeve. Në janar, qeveria vendosi që disa kategori të caktuara zgjedhësish të cilët nuk kishin pasaportë, të paguanin një tarifë të reduktuar, ose të mos paguanin asgjë për kartat e identitetit. Pas një sërë negociatash intensive, më 28 prill Partia Demokratike dhe Partia Socialiste arritën në kompromis, sipas së cilit tarifa fillestare që duhej paguar për kartat e identitetit nga ata zgjedhës që nuk kanë pasaportë, të ulet në 200 lekë (më pak se 2 euro), ndërkohë që pjesa e mbetur e tarifës të paguhet nga qytetari/ja më vonë. Për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, më 30 prill qeveria hapi një linjë kreditimi.

## IX. MEDIA

Media televizive dhe radiofonike përbën burimin kryesor informativ për qytetarët. Në mungesë të kërkesave kufizuese të dhënies së licencave, deri tani Këshilli Kombëtar i Radio-Televizionit ka licencuar tre stacione televizive komerciale me shtrirje kombëtare, 69 stacione televizive lokale dhe 50 stacione televizive kabllore. Edhe pse nuk dihet vërtet pjesa reale që kanë në treg këto transmetues, kanalet private *Top Channel*, *TV Klan*, *Vizion Plus* si edhe *Neës24* e *Alsat*, të cilat shfaqin vetëm lajme, konsiderohen si kanalet më të ndjekura televizive.

Numri i lartë i mediave që konkurrojnë në një treg të kufizuar reklamash (me një shifër të përafërt prej 21 milion eurosh në vit), si edhe mungesa e transparencës për financimin e tyre, kanë krijuar shqetësim tek gazetarët dhe profesionistët e mediave kombëtare dhe atyre ndërkombëtare për ndërhyrje në media nga ana e grupeve të biznesit dhe atyre politike me aludime autocensure dhe rreziku për pavarësinë e medias. Në përgjithësi, mediat më të

rëndësishme televizive dhe ato të shkruara, konsiderohen të jenë mbështetëse të njëres prej dy partive kryesore politike, ndërkohë që media përgjithësisht shihet si pluraliste, por jo e pavarur nga influenca politike.

Nga të gjithë transmetuesit, pjesën më të madhe të territorit të Shqipërisë e mbulon transmetuesi publik (RTSH), reforma e të cilit ka ngecur. RTSH-ja ende mbetet e varur financiarisht nga buxheti i shtetit, duke qenë se vetëm nëntë përqind e të ardhurave të saj përfitohen nga taksa vjetore. Po ashtu, ka patur aludime se caktimi në detyrë dhe largimi nga detyra i punonjësve të lartë të RTSH-së ka qenë me motivacion politik. Shumë mendojnë se RTSH-ja i shërben qeverisë dhe partisë në pushtet, dhe se nuk është një transmetues i vërtetë publik.

Kodi Zgjedhor rregullon mbulimin e fushatës zgjedhore në media. Dispozitat për median kanë të bëjnë me median radiotevizive në mënyrë ekskluzive, dhe zbatohen vetëm gjatë periudhës zyrtare të fushatës, e cila fillon 30 ditë përpara ditës së zgjedhjeve. Radiotevizionit publik i kërkohet që të vërë minutazh falas në dispozicion të partive që konkurrojnë në zgjedhje, si edhe një periudhë kohore prej dy orësh falas në dispozicion të KQZ-së për transmetime me qëllim informimin e zgjedhësve. Koha e minutazhit falas që u vihet në dispozicion partive politike varet nga përfaqësimi i tyre në Kuvend. Kështu, partitë parlamentare që kanë marrë më shumë se 20 për qind të vendeve në Kuvend, marrin edhe sasinë më të madhe të minutazhit. Transmetuesit privatë mund të venë kohë në dispozicion të partive për reklama me pagesë. Përveç kësaj, Kodi Zgjedhor detyron transmetuesit privatë kombëtare dhe satelitorë që gjysmën e kohës totale të blerë nga partia politike për reklamë, ta vënë në dispozicionin e tyre falas. Transmetuesëve publikë dhe privatë u kërkohet të pasqyrojnë fushatat zgjedhore të partive në edicionet e tyre informative. Pasqyrimi mediatik i fushatës zgjedhore monitorohet nga Bordi i Monitorimit të Medias, i cili u krijua nga KQZ-ja më 19 maj. Aktiviteti i këtij Bordi rregullohet nga Kodi Zgjedhor.

Në mënyrë që të vlerësojë pasqyrimin e fushatës në media, që nga data 18 maj, Misioni Vëzhgues i OSBE/ODIHR-it ka filluar të bëjë monitorimin e medias për transmetimet që shfaqen në orët me shikueshmëri më të lartë, në pesë kanale televizive (*TVSH, Top Channel, TV Klan, Vizion Plus* dhe *Neës24*), si edhe përmbajtjen e katër gazetave ditore (*Panorama, Shqip, Gazeta Shqiptare* dhe *55*).

## **X. ANKIM NË RRUGË ADMINISTRATIVE OSE GJYQËSORE**

KQZ-ja është autoriteti përgjegjës për shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankimeve, si edhe për gjykimin e ankimeve në rrugë gjyqësore kundër vendimeve të KZAZ-ve. Po ashtu, KQZ-ja vendos për ankime kundër vendimit të KQZ-së për “Aprovimin e Përmbledhjes së Rezultatit të Zgjedhjeve” dhe për kërkesat për të shpallur një zgjedhje të pavlefshme. E drejta e ankimit u jepet ‘subjekteve zgjedhore’, p.sh. partive, koalicioneve apo kandidatëve të regjistruar nga KQZ-ja për zgjedhjet, individëve apo partive të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor, si edhe subjekteve të cilave u është refuzuar kërkesa për akreditimin e vëzhguesve. Përveç kërkesës për t’u shtuar në listën e zgjedhësve në kushte të veçanta (shih më lart), zgjedhësit, si individë, nuk mund t’i drejtohen gjykatës, në rast se janë shkelur të drejtat e tyre zgjedhore.

Ankimet kundër të gjitha vendimeve të KQZ-së mund të bëhen brenda pesë ditëve në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit në Tiranë. Sipas Kodit Zgjedhor, vendimet e Kolegjit Zgjedhor janë përfundimtare dhe kundër tyre nuk mund të bëhen ankime. Megjithatë, Kushtetuta e Shqipërisë i jep Gjykatës Kushtetuese juridiksion mbi çështje që kanë të bëjnë me plotësimin e kushteve për përshtatshmërinë e kandidatëve për t’u regjistruar si të tillë, si edhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre.

Deri tani, në Kolegjin Zgjedhor janë dorëzuar vetëm dy ankime, njëra kundër një vendimi të KQZ-së për caktimin e anëtarëve të KZAZ-së, dhe një e dytë kundër një udhëzimi të KQZ-së për dokumentacionin e kërkuar për regjistrimin e kandidatëve. Kolegji Zgjedhor nuk e shqyrtoi vlefshmërinë e ankimeve dhe i hodhi ato poshtë për arsye proceduriale.

## **XI. PJESËMARRJA E GRAVE DHE MINORITETEVE KOMBËTARE**

Roli i grave në jetën politike shqiptare mbetet i kufizuar. Në parlamentin shqiptar të cilit po i mbaron afati, nga 140 deputetë, vetëm 10 janë femra (7 përqind,) përfshirë edhe Kryetaren e Kuvendit. Kodi i ri Zgjedhor përcakton se listat e çdo partie për secilën zonë duhet ose të përmbajnë të paktën 30 përqind nga secila gjini, ose të paktën një nga tre kandidatët e parë për çdo listë të jenë nga secila gjini. Pra, teorikisht, partitë me 30 përqind të kandidatëve gra të vendosura të gjitha në fund të listës nuk bien në kundërshtim me ligjin. Kodi gjithashtu përmban dispozita që garantojnë pjesëmarrjen e grave dhe burrave në KQZ dhe KZAZ. Dy nga shtatë anëtarët e KQZ-së janë gra. Kërkesa që çdo gjini të përbëjë të paktën 30 përqind të anëtarëve të emëruar në KZAZ nuk u respektua nga të gjitha partitë. KQZ-ja informoi Misionin Vëzhgues të OSBE/ODIHR-it se anëtarët e caktuar u pranuan pavarësisht nga ky fakt, për shkak të afrimit të afatit për ngritjen e KZAZ-ve.

Kushtetuta u garanton të drejta të plota pakicave apo minoriteteve kombëtare. Minoriteti më i madh është komuniteti greko-shqiptar, që jeton kryesisht në jug të vendit. Minoritete më të vogla janë ato me etni maqedonase, bullgare, serbe, malazeze, boshnjake, vllahe dhe rome. Partia e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut dhe PBDNJ-ja (pjesë e Aleancës Socialiste për Integrim) konkurrojnë për votat e komunitetit greko-shqiptar. E regjistruar në këto zgjedhje është edhe Aleanca e Maqedonasve për Integrim European, pjesë e koalicionit të udhëhequr nga PD-ja. Partia e Tolerancës së Re, e cila mbron interesat e komunitetit rom, është pjesë e Aleancës Socialiste për Integrim.

## **XII. VEPRIMTARIA E MVZ-SË TË OSBE/ODIHR-IT**

Zyra e Misionit Vëzhgues (MVZ) së OSBE/ODIHR-it u hap në Tiranë më 8 maj 2009. Shefja e Misionit është takuar me anëtarët e KQZ-së, Zëvendësministrin e Brendshëm, kryetarët e disa partive parlamentare (deri tani PD-ja ka pranuar kontakte në nivel pune) dhe disa partive joparlamentare, Kreun e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri dhe Ambasadorët e vendeve pjesëmarrëse në OSBE. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it ka takuar gjithashtu përfaqësues të Kryeministrit dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe ka mbajtur kontakte të rregullta me KQZ-në, partitë politike, shoqërinë civile dhe median. Vëzhguesit afatgjatë po takohen me aktorë të ndryshëm për zgjedhjet në zonat përkatëse.